



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 21.07.2022
Nr. 5-1647

Komisioni për licencimin e BPrAL / kolegjeve private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 1647 të datës 04.07.2022 të parashtruar nga BPrAL-Kolegji “RIINVEST” dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për Licencim e kolegjit “RIINVEST” .
2. I ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për vitin akademik 2022/23.
3. Lejohet vazhdimi i studimeve deri në përfundimin e tyre për studentët aktiv.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim të BPrAL të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 1647 të datës 04.07.2022 të parashtruar nga kolegji “RIINVEST”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Duke u bazuar në vendimin nr. 265/22 të datës 07.03.2022, lëshuar nga Agjencioni i Kosovës për Akreditim sipas pikës 1, I refuzohet kërkesa e kolegjit “RIINVEST” nr. 212/22H datë 11.02.2022 për riakreditim institucional;

Sipas UA nr. 25/2012, neni 7, paragrafi 2.15. objekti ku zhvillohet veprimtaria arsimore dhe akademike e kolegjit “Riinvest” nuk ka leje të ndërtimit të objektit prandaj, komisioni për licencim i MASHTI-t, refuzon kërkesën për licencim, duke u bazuar në kriteret e cekura më lartë.

Kolegjit "RIINVEST", i lejohet vazhdimi i punës me studentët aktiv (ekzistues) deri në përfundim të studimeve të tyre.

Komisioni për licencim i MASHTI-t, duke marrë parasysh mungesën e fakteve të ofruara në dokumentacionin për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Sekretarit të përgjithshëm në MASHTI;
3. Departamentit të arsimit të lartë në MASHTI;
4. Inspektoratit të Arsimit;
5. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

